



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 29.10.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novobërdaliu – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi, Albana Gashi, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Pula

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj, koordinator, Sulltane Gashi, zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Nevahir Hazeri, KDI; Ukë Gashi, ZPRK; Elita Vokshi, OSBE; Jan Pekins dhe Shpend Qamili, OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novobërdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara,
3. Shqyrtimi i peticioneve,
4. Të ndryshme.

Kryetarja- Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Ajo fillimisht njoftoi anëtarët e Komisionit, se e ka hequr një pike nga rendi i ditës, ku ishte caktuar takim i përbashkët i Komisionit, me OSBE-në dhe Zyrën për Barazi

Gjinore, ku ishte paraparë një trajnim i përbashkët për rrjedhën e procesit të alokimit të fondeve nga ABGJ--ja dhe mënyra se si ato fonde shpenzohen. Ajo tha, se për momentin e kemi hequr nga rendi i ditës, dhe do të marrim qëndrim bashkë se si të veprojmë me tutje.

Kimete Bajraktari –Tha se është e mendimit që “Agjencinë për Barazi Gjinore ta ftojme për të raportuar në Komision dhe të mbahet trajnimi, pra të kryhen të dy punët njëkohësisht”.

Rita Hajzeraj - Tha se reagimi i ABGJ-së është i padrejtë. “Ne si Kuvend e kemi rolin e mbikëqyrjes së Qeverisë. Unë mendoj që ne si Komision t’ia dërgojmë një reagim ABGJ-se, në mënyrë që t’i tregojmë se cili është mandati i jonë, dhe ata të përgjigjen para Komisionit. Ne kemi të drejtë të kemi qasje në të dhënat zyrtare”.

Albana Gashi - Duke u ndërlidhur me këtë, shtoi se duhet të vazhdohet me trajnimin. “Përmes këtij trajnimi, ne kemi vërejtur se ato mjete nuk janë nda në mënyrë të rregullt. Duhet të mbahet trajnimi dhe të ftohen palët në Komision”.

Kurtan Kajtazi - Tha se pajtohet me parafolësit se duhet të raportohet para Kuvendit për shpenzimet, por me ardhur në trajnime dhe dëgjime publike nuk e kanë të obliguar, do të ishte mire që ABGJ me ardhje me na ndihmuar, por nuk e kanë obligative një gjë të tillë,

Komisioni pasi që debatoi, lidhur me këtë mori këtë;

Përfundim

Komisioni kërkon nga Agjencia për Barazi Gjinore, raport me shkrim për shpenzimin e mjeteve dhe subvencioneve dhe pastaj të ftohen në takim për të raportuar.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Kryetarja- Tha se në procesverbalin e datës 10.10.2012, kishte vërejtur një lëshim, por është përmirësuar me kohë nga ana e administratës së Komisionit.

Albana Gashi - Tha se në procesverbalin e datës 11.09.2012, të kërkesa e M.L.L., sa për sqarim fjalisë se “ nuk e kupton veprimin e autoriteteve dhe shkaqet e mosrealizimit të kësaj kërkesë, duhet t’i shtohen edhe këto fjalë, sepse arsyetimi për mos lirimin me kusht, nuk është bindës”, sepse fjalia ashtu siç ishte, ishte e pakuptimtë. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 19 shtator dhe 10 tetor 2012, u miratuan pa vërejtje, ndërsa procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 11 shtator, u miratua me vërejtjen e anëtares së Komisionit, Albana Gashi.

3. Shqyrtimi i peticioneve,

Kurtan Kajtazi - Në cilësi të raportuesit, tha se i kemi për shqyrtim dy peticione, që janë shpërndarë me material, dhe një peticion ka arritur sot. Nëse lejohet me pajtim të Komisionit, do ta shqyrtojmë edhe këtë.

Kryetarja - Tha se meqenëse nuk ishte peticion i komplikuar, “jam e mendimit që ta shqyrtojmë sot”.

Kurtan Kajtazi - Tha se “e kemi peticionin e fshatit Zllatar dhe dy fshatrave të tjera të Komunës së Ferizajt, që kërkojnë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave, që të marrin masa për shtrirjen e rrjetit të valëve të radio televizionit në këto fshatra. Banorët e këtyre fshatrave, që nga pas lufta nuk kanë sinjale të televizioneve nacionale. Këta banorë i kanë kryer pagesat për Radio Televizionin e Kosovës, ne nuk kemi mundësi që ti ndihmojmë për TV private, por për RTK-në, jemi të mendimit t’ia dërgojmë Komisionit FunkSIONAL, që është përgjegjës për Komisionin e Pavarur për Media, për të gjetur mundësinë duke kërkuar nga Komisioni i Pavarur për Media, që të shikohet mundësia e shtrirjes së rrjetit edhe në këto fshatra, sepse janë qytetarë të Kosovës dhe janë pagues të rregullt dhe është e drejtë e tyre, veçmas për RTK-në.

Komisioni lidhur me këtë kërkesë vendosi të nxjerr këtë:

Përfundim

Komisioni FunkSIONAL, që është përgjegjës për Komisionin e Pavarur për Media të gjejë mundësinë dhe të kërkojë nga Komisioni i Pavarur për Media, që të shikohet mundësia e shtrirjes së rrjetit edhe në këto fshatra, sepse janë qytetarë të Kosovës dhe janë pagues të rregullt dhe është e drejtë e tyre, veçmas për RTK-në.

Kurtan Kajtazi - Tha se e kemi kërkesën e një qytetari nga Peja, Tahir Shaboviq, që kërkon nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione t’i ofrohet ndihmë materiale, sepse pensioni prej 80 euro, nuk po i mjafton as për barna, e lere më për nevojat të tjera familjare.

Ai, tha se kjo kërkesë nuk bie në fushëveprimtarinë e Komisionit. Ky e ka paraqitur një kërkesë edhe në Komunën e Pejës. Komuna e Pejës i ka ndihmuar me disa mjete. Kjo kërkesë është kompetencë e Komunës, banor i se cilës është personi.

Komisioni pas një debati konstruktiv nxori këtë:

Përfundim

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj, e udhëzon paraqitësin e peticionit që për realizimin e këtyre pretendimeve t’i drejtohet me kërkesë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe Ministrisë për Shëndetësi.

Kurtan Kajtazi - Tha gjithashtu se “kemi edhe një kërkesë nga Lidhja e Invalidëve dhe Viktimave të Luftës në Kosovë, është fjala për Luftën e Dytë Botërore. Kjo Shoqatë ka gëzuar të drejta dhe beneficione, prej vitit 1976, deri në fund të tetorit, të vitit 1998, janë thirrur me një ish-ligj të ish- KSA të Kosovës, që kanë pasur të drejta në beneficione, dhe numri i përgjithshëm i tyre është 373. Invalidët janë të ndarë në tri grupe: grupi i parë prej 70 personave, grupi i dytë, prej 178 personave dhe grupi i tretë, prej 116 personave. Dhe kjo kategori e invalidëve kërkon që të gëzojnë të drejtën e tyre edhe në Republikën e Kosovës, sepse është e vetmja Republike, e cila nga vendet e ish-Jugosllavisë, këta invalidë nuk i gëzojnë këto beneficione.

Ai, më tutje shtoi se është mirë në emër të Komisionit, t’ia dërgojmë një kërkesë Ministrisë për Mirëqenie Sociale dhe me rishikimin e ligjit për vlerat e luftës, të shikohet mundësia e përfshirjes së këtyre invalidëve, meqenëse nuk është numër i madh.

Albana Gashi - Tha se Ligji për Invalidët e Luftës përfshinë personat e periudhës se caktuar, nuk është e përfshirë kjo periudhë kohore.

Kurtan Kajtazi – “Mund të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i ligjit. Ne të bëjmë propozimin në Ministri, dhe ata të na njoftojnë, se cila është mundësia për këtë kategori”.

Albana Gashi – “Kërkoj që çdo kërkesë që bëhet për institucionet, nga ana e Komisionit, ta kenë edhe anëtarët e Komisionit. Po ashtu, edhe përgjigjet që i dërgojnë ata lidhur me ato shkresa”.

Kryetarja - Tha se “jemi te pajtimin që të kërkojmë nga Ministria përkatëse, plotësim ndryshimin e ligjit, që në te, të përfshihet edhe kjo kategori e invalidëve të kësaj periudhe për beneficione”.

Komisioni pas një debati konstruktiv lidhur me këtë nxori këtë:

Përfundim

Komisioni i rekomandon Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që brenda kompetencave të saj, të shqyrtojë kërkesën e Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile, të plagosur para Luftës së UÇK – së në Kosovë, me qëllim që kjo kategori të gëzojë të drejta dhe mbrojtje institucionale, deri në nxjerrjen e ligjit të veçantë.

4. Të ndryshme

Kryetarja – Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me ftesën për vizitën që do të bëhet në Bruksel. Ajo tha se atje do të udhëtojë një grup në përbërje prej 4 anëtarëve: Suzan Novoberdaliu, Kurtan Kajtazi, Biserka Kostiq dhe Kimete Bytyçi. Prej administratës e ka caktuar Rrahim Demën, kështu që, çdo udhëtim që do të bëhet, do të kenë mundësi që të përfshihet secili me radhë.

Albana Gashi - U interesua të dijë se çka është ndërmarrë lidhur me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me protestën e 14 dhe 22 janarit, të organizuar

nga Lëvizja “Vetëvendosja”. Po bëhet gati një vit që ai raport ka ardhur në Komision dhe nuk e kemi shqyrtuar. Tash edhe pak kohë vjen edhe raporti tjetër, e ne ende nuk e kemi shqyrtuar raportin parë.

Kurtan Kajtazi – “Kemi kërkuar raportin me shkrim nga Inspektorati Policor i Kosovës. Ata e kanë dërguar raportin me shkrim kurse në Komision nuk kanë ardhur për të raportuar”.

Albana Gashi - Tha se është e mendimit që kur të vijë edhe raporti tjetër, t’i shqyrtojmë të dy raportet përnjëherë.

Komisioni u pajtua që kur të vijë edhe raporti tjetër, të vendosen si pikë e rendit të ditës, të dy raportet dhe të shqyrtohen bashkërisht.

Kryetarja - Tha se revista „Kuvendi” nr. 35, e botuar në muajin korrik, “nuk e ka përmendur Komisionin tonë si Komision Funkcional fare. Ne, në raportin e fizibilitetit kemi hy si Komisioni më i suksesshëm, pra janë përmendur si Komisione të suksesshme e ku njëri ndër ta, është edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, ndërsa, këtu, në këtë revistë mungon Komisioni ynë. Nuk e shohin të arsyeshme t’i shkruajnë disa fjalë për Komisionin tonë”.

Ajo më tej tha, se duhet bërë një reagim në emër të Komisionit të Zyra për Media, pasi që Komisioni ynë nuk figuron fare dhe po ashtu asnjë aktivitet i Komisionit nuk është i përfshirë.

Rita Hajzeraj - Tha se është mire për këtë të merret fjala, dhe, edhe në seancë të bëhet një reagim i tillë.

Komisioni lidhur me këtë vendosi, që të bëjë një reagim me shkrim, pasi që Komisioni ynë nuk figuron fare dhe po ashtu asnjë aktivitet i Komisionit nuk është i përfshirë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu